




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3040/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit ISPE, Nr. 2201/21H, datë 04.06.2021 për akreditim të programeve të studimit si më poshtë:
 - Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS;
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji ISPE ka parashtruar kërkesë Nr. 2201/21H, datë 04.06.2021 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim të programeve të studimit si në vijim: Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, dhe Infermieri BSc, 180 ECTS

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur me 07 dhe 27 korrik 2021 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit ISPE. Në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KSHC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. *Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KSHC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së*".

Mbi këtë bazë, KSHC erdhi në përfundim se programi i studimit të Kolegjit ISPE, Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të LAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar të gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 07 dhe 27 korrik 2021, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzoj aprovimin e aplikacionit të Kolegjit ISPE, sipas pikës një të dispozitivit të këtij vendimi.

1. **Për programin e studimit:** *Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS*, Kolegji ISPE ka paraparë këta persona si bartës të këtij programi të studimit: Avni Mazreku, Rifat Demaliaj, Aleksandër Muskaj dhe Petrit Perhati.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të LAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji ISPE, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE për këtë program të studimit, u konstatua që tre nga katër bartësit e programit të prezantuar në këtë program të studimit, nuk i plotësojnë kushtet sipas Udhëzimit Administrativ.

Nga bartësit e programit të sipër përmendur, pas verifikimit të dokumentacionit, KShC ka konstatuar se Avni Mazreku ka diplomë doktrate në fushën e Shkencave Juridike, dhe jo atë të studimeve të sigurisë. Aleksandër Muskaj ka diplomë doktrate në fushën e Shkencave Juridike, dhe në dokumentacionin e dorëzuar figuron si i punësuar në Shqipëri, që bie në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 15/2018, Neni 30, pika 5 e cila përcakton se: *Për qëllime të akreditimit, stafi akademik të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës duhet të posedojnë leje qëndrimi dhe leje të punës në Republikën e Kosovës*. Po ashtu ky staf akademik duhet të sjellë dëshmi nga institucioni relevant nga vendi i origjinës (p.sh. Administrata Tatimore) se nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës në vendin e tij të origjinës. Gjithashtu Neni 30, pika 6, e cila përcakton se: AKA do të bëjë verifikimin e stafit akademik të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe në rast se figurojnë si anëtarë të rregullt në universitet apo institucione të tjera në vendin e tyre, ata nuk do të pranohen si staf i rregullt për qëllime të akreditimit, përkatësisht, si bartës të programeve të studimit. Ndërsa që z. Petrit Perhati nuk ka dorëzuar fare dokumentin e ID apo Leje qëndrimi, ashtu siç është e paraparë me pikën 5 të Nenit 30, të këtij UA.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KShC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson

kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Studime të sigurisë, BA, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, Kolegji ISPE ka parashtruar kërkesë Nr. 2201/21H, datë 04.06.2021 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim të programit të studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS*.

Për programin *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi, Kolegji ISPE, ka paraparë këta persona: Vlora Pruthi, Nexhmije Gori, Xhevahire Ymeri, Ganimete Gjokaj, Armenitë Mazreku, Arbenita Peci.

Sipas nenit 26, pika 5.3.1, programet e studimit duhet të ligjërohen nga stafi akademik me kualifikime relevante akademike profesionale. Ndërsa që neni 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, përcakton se "*Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc, Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar*". Përveç kushteve të cekura më sipër IAL-të duhet të kenë staf permanent nga fusha e programit të studimit, të paktën me gradën MA.


Bazuar në nenin e referuar më sipër, KShC ka verifikuar të gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit, dhe këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 07 dhe 27 korrik 2021, me ç' rast është konstatuar se: znj. Nexhmije Gori ka diplomë në Menaxhment Sektorial MA, e që nuk është e fushës së infermierisë. Znj. Ganimete Gjokaj ka diplomë në Psikologji Klinike MA Profesional, e që nuk është e fushës së infermierisë. Armenitë Mazreku ka diplomë në fushën e farmacisë, e që nuk është nga fusha e infermierisë. Për znj. Arbenita Peci nuk është dorëzuar fare diploma e nivelit master, rrjedhimisht nuk ka plotësuar kriterin bazë. Në plotësimin e deklartimit si staf akademik, znj. Peci ka cekur që ka përfunduar studimet në nivelin master në fushën e Edukimit Shëndetësor që përsëri nuk është në fushën e infermierisë, ashtu sic kërkohet me UA 15/2018.

Prandaj, bazuar në faktin se Kolegji ISPE ka prezantuar vetëm dy (2) bartës të programit nga fusha e Infermierisë, dhe jo 3 (tre) bartës, ashtu siç është e precizuar me UA 15/2018, Neni 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.11 (1 staf akademik për 60 ECTS), KShC ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "ISPE";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

